



Republika e Kosovës
Qeveria - Vlada – Government

***Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë -Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva i Trgovine -Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade***

Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

Nr.Ref.01/63
21.08.2023

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 11, paragrafit 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), nenit 46 të Ligjit Nr. 04/L-240 Për Masat Antidamping Dhe masat Kundërbalancuese, si dhe nenit 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 dhe Shtojcës 12 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive merr:

V E N D I M

1. Ndërpritet masa mbrojtëse Antidamping mbi sektorin e prodhimit të koncentratit për shpejë dhe kafshë nga Serbia.
2. Obligohet Dogana e Republikës së Kosovës që të zbatoj këtë vendim.

ARSYETIM

Pas pranimit të kërkesës së Shoqatës së Shpendarëve të Kosovës e cila ka kërkuar që të shfuqizohet masa në fuqi, si dhe kërkesës së bërë nga ose në emër të industrisë vendore të Kosovës, kërkesë kjo për zgjerim të kodeve doganore në komplet kreun, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë respektivisht Departamenti i Tregtisë, në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe, konform nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-240 Për Masat Antidamping Dhe masat Kundërbalancuese, kanë shqyrtuar kërkesat, po ashtu ka zhvilluar disa takime me kompanitë prodhuese, me Doganën e Kosovës, ASK dhe nga të dhënat të marra në teren nga prodhuesit,

importuesit si dhe nga pikat shitëse, shihet se prodhimi vendor nuk i plotëson kushtin kryesor për mbrojtje me masën anti dumping pasi që kemi ndryshim të çmimeve të ushqimit të koncentruar për shpeze dhe kafshe në treg, ku produktet serbe në Kosovë që janë shqyrtim i kësaj mase janë më të shtrenjta si dhe sasia e prodhimit të këtij produkti është me e vogël se (50%) të prodhimit total të produktit të ngjashëm, pra prodhimi i këtij produkti nuk e ka plotësuar kushtin i cili parashihet në paragrafin 6 të nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-240 Për Masat Antidamping dhe masat Kundërbalancuese, citoj:

Do të konsiderohet se kërkesa është bërë nga ose në emër të industrisë vendore të Kosovës vetëm nëse është mbështetur nga:

- ***6.1. ose Prodhuesit Kosovar prodhimi i të cilëve përbën baras ose më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të prodhimit total të produktit të ngjashëm; ose,***
- ***6.2. nëse kundërshtimi i shprehur për aplikimin e prodhuesve të Kosovës është më pak se prodhimi i këtyre prodhuesve që e mbështesin kërkesën.***

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë respektivisht Departamenti i Tregtisë në konsultim me Komisionin për Vlerësimin e Masave Mbrojtëse në Importe, duke u bazuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 04/L-240 Për Masat Antidamping dhe masat Kundërbalancuese, si dhe në bazë të analizës së të dhënave nga ky komision e cila u prezantua si analizë finale të datës 29.03.2023, rekomandon ndërprerjen e masës mbrojtëse anti-damping mbi sektorin e prodhimit të Koncentratit për shpeze dhe kafshë në bazë të dhënave të lartë cekura.

Duke u bazuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 04/L-240 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese si dhe bazuar në rekomandimin e lartcekur, Ministria vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë padi në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 dite nga dita e pranimit.

Rozeta HAJDARI

Ministre

Vendimi i dërgohet:

- Dogana e Kosovës;
- Kabinetit;
- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/MINT;
- Anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Masave Mbrojtëse në Importe;
- Departamentit të Tregtisë;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit.